



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 449/ 2010**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Vlastimir Dimić dhe Nehat Idrizi, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 15.12.2010, mori këtë:

## V E N D I M

**REUZOHET** ankesa si e pabazuar e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV).

## A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 12.12.2010, nga subjektit politik LVV, ne te cilën pretendohet se “më datë 12.12.2010 rreth orës 11:20, në shkollën “Gani Çavdërbashi” në Prizren, është parë një person që se bashku me Policinë e Kosovës, ka qene duke shpërndarë fletëvotime. Në ankesë theksohet se për këtë posedojmë edhe xhirime filmike”. Parashtruesi i ankesës kërkon nga PZAP-i që urgjentisht të merren masat ligjore për rastin konkret.

Në raportin e Policisë së Kosovës, datë 12.12.2010, me nr. SPP-01-95/2010, theksohet se: Policia e Kosovës se bashku me zv. menaxherin kanë dalë jashtë Qendrës së Votimit dhe kanë kontaktuar personin, i cili ishte duke shpërndarë fleta udhëzuese (të printuara nga faqja elektronike e internetit), të cilat janë verifikuar se janë udhëzues se si të votohet për Partinë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe nuk ishin fleta origjinale për të votuar. Pas kësaj zv. Menaxheri i është drejtuar të miturit që ishte rreth 13 vjeç, që se bashku me fletushkat të largohet nga lokacioni ku ka bërë shpërndarjen e udhëzuesve. Më kërkesën e pjestarëve të policisë së Kosovës është bërë sekuestrimi i tri fletushkave (udhëzuesve).

**Neni 118 paragrafi 1 LZP-së, parasheh:**

*118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.*

*118.4 Mund të apelohej vendimi i PZAP-it, sikurse që PZAP-i mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e*

*interesuar.*

PZAP duke u bazuar në dispozitën e nenit 118.4 të LZP-së, rezervon të drejtën për të rishqyrtuar këtë ankesë kurdo që Policia e Kosovës dhe pala e interesuar do të sjellin fakte të reja lidhur më rastin konkret.

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

**- ankesa është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se pretendimet e parashtruesit të ankesës, se është parë një person duke shpërndarë fletëvotime nuk janë të bazuara, për shkakun se provat e ofruara nuk janë të asaj natyre për të besuar se ka ndodhur shkelja e tillë. Ky fakt konfirmohet edhe nga raporti i policisë i datës 12.12.2010, me nr. SPP-01-95/2010, në të cilën theksohet se ka qenë një i mitur rreth 13 vjeç duke shpërndarë udhëzime se si të votohet për PDK. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekura më lartë e po ashtu në pajtim më dispozitat e cituara ligjore si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 449/2010 më datën 15.12.2010.

